



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

**PROJEKTLIGJI PËR MBIKËQYRJEN ELEKTRONIKE TË PERSONAVE TË CILËVE U KUFIZOHET
LËVIZJA ME VENDIM TË GJYKATËS OSE TË PANELIT PËR LIRIM ME KUSHT¹**

**DRAFT LAW ON THE ELECTRONIC SUPERVISION OF PERSONS WHOSE MOVEMENT IS LIMITED
BY THE DECISION OF THE COURT OR OF THE CONDITIONAL RELEASE PANEL²**

**NACRT ZAKONA O ELEKTRONSKOM NADZORU LICA KOJIMA SE ODLUKOM SUDA ILI VEĆA ZA
USLOVNI OTPUST OGRANIČAVA KRETANJE³**

¹Projekt Ligji për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të Cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës ose të Panelit për Lirim me Kusht, është miratuar në mbledhjen e 141 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin nr. 02/141 me datë 26.07.2013

²Draft Law on the Electronic Supervision of Persons Whose Movement is Limited by the Decision of the Court or of the Conditional Release Panel, was approved on 141 meeting of the government of the Republic of Kosovo with the decision no. 02/141 date 26.07.2013

³Nacrt Zakona o Elektronskom nadzoru lica kojima se Odlukom Suda ili Veća za Uslovni Otpust Ograničava Kretanje, osvojen je na 141 sednice vlade republike kosova, odluku br. 02/141, datum 26.07.2013

<p>Kuvendi i Republikës së Kosovës,</p> <p>Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,</p> <p>Miraton:</p> <p style="text-align: center;">LIGJI PËR MBIKËQYRJEN ELEKTRONIKE TË PERSONAVE, TË CILËVE U KUFIZOHET LËVIZJA ME VENDIM TË GJYKATËS OSE TË PANELIT PËR LIRIM ME KUSHT</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Qëllimi i këtij ligji është të rregulloj përdorimin e mbikqyrjes elektronike në procesin e drejtësisë penale për të ngritur sigurinë publike dhe për të garantuar ekzekutim efektiv të vendimeve të gjykatës dhe të Panelit për lirim me kusht, duke i respektuar plotësisht të drejtat e personave të përfshirë.</p>	<p>The Assembly of the Republic of Kosovo,</p> <p>Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,</p> <p>Adopts:</p> <p style="text-align: center;">LAW ON THE ELECTRONIC SUPERVISION OF PERSONS WHOSE MOVEMENT IS LIMITED BY THE DECISION OF THE COURT OR OF THE CONDITIONAL RELEASE PANEL</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER I GENERAL PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>The purpose of this law is to regulate the use of electronic supervision in the criminal justice process in order to enhance public safety and ensure effective execution of decisions of the court and those of the conditional release Panel, by fully respecting the rights of the persons involved.</p>	<p>Skupština Republike Kosova,</p> <p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo,</p> <p>Usvaja:</p> <p style="text-align: center;">ZAKON O ELEKTRONSKOM NADZORU LICA KOJIMA SE ODLUKOM SUDA ILI VEĆA ZA USLOVNI OTPUST OGRANIČAVA KRETANJE</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Cilj</p> <p>Cilj ovog zakona je da reguliše primenu elektronskog nadzora u procesu krivičnog pravosuđa za povećanje javne bezbednosti i da se obezbedi efikasno izvršenje sudskih odluka i odluke veća za uslovni otpust, uz puno poštovanje prava lica koja su uključena.</p>
---	--	--

<p align="center">Neni 2 Fushëveprimi</p>	<p align="center">Article 2 Scope</p>	<p align="center">Član 2 Delokrug</p>
<p>1. Ky ligj zbatohet për mbikëqyrjen elektronike të personave, ndaj të cilëve me vendim të gjykatës janë vendosur:</p> <p>1.1. masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit, të parashikuar nga nenet 176, 177 dhe 183 të Kodit të Procedurës Penale;</p> <p>1.2. dënimet alternative, të parashikuara nga nenet 53, 57, 58, 59 nënparagrafët 1.7 dhe 1.9 si dhe nenit 61 të Kodit Penal;</p> <p>1.3. urdhrat mbrojtës ose të mbrojtjes emergjente, të parashikuar me nenin 5 të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.</p> <p>2. Ky ligj zbatohet për mbikëqyrjen elektronike të personave, edhe në rastet kur Paneli për Lirim me kusht merr vendim për lirim me kusht të personave nga burgu në bazë të nenit 94 të Kodit Penal.</p>	<p>1. This law is applied for the electronic supervision of persons who by a court decision have been enforced:</p> <p>1.1. measures to ensure presence of the defendant, foreseen by articles 176, 177 and 183 of the Criminal Procedure Code;</p> <p>1.2. alternative punishments foreseen by articles 53, 57, 58, 59 and subparagraphs 1.7 and 1.9 of article 61 of the Criminal Code;</p> <p>1.3. protection or emergency protection orders foreseen by article 5 of the Law for Protection from Domestic Violence.</p> <p>2. This law shall be applied for the electronic supervision of persons even in cases when the Conditional Release Panel decides to release persons from prison on condition pursuant to Article 94 of the Criminal Code.</p>	<p>1. Ovaj zakon se primenjuje za elektronski nadzor lica protiv kojih su odlukama sudova donete:</p> <p>1.1. mere za obezbeđivanje prisustva okrivljenog, kako je predviđeno članom 176, 177 i 183 Zakonika o krivičnom postupku;</p> <p>1.2. alternativne kazne, predviđene članovima 53, 57, 58, 59 i stavovima 1,7 i 1,9 člana 61 Krivičnog zakonika;</p> <p>1.3. nalozi o zaštiti ili hitnoj zaštiti, kako je predviđeno članom 5 Zakona o zaštiti od nasilja u porodici.</p> <p>2. Ovaj zakon se primenjuje za elektronski nadzor lica i u slučajevima kada veće za uslovni otpust donese odluku o uslovnom puštanju na slobodu lica iz zatvora, na osnovu člana 94 Krivičnog zakonika.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p>
<p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. mbikëqyrje elektronike- nënkupton mekanizmin që garanton zbatimin efektiv të vendimit të gjykatave dhe të Panelit për lirim me kusht, nëpërmjet përcaktimit në kohë reale të vendndodhjes së një personi, me anë të përdorimit të mjeteve elektronike të vendosura në trupin e tij;</p> <p>1.2. pajisje – nënkupton mjetin elektronik i vendosur në trupin e subjektit dhe që mundëson përcaktimin në kohë reale të vendndodhjes së tij;</p> <p>1.3. person i afërt –nënkupton personin që ka lidhje të afërta familjare në vijë të drejtë pa kufij ndërsa në vijë të tërthort deri në shkallë të tretë me personin dhe/ose jeton në të njëjtën shtëpi me të;</p> <p>1.4. sallë operative- nënkupton zyrën e cila funksionon në kuadër të Shërbimit Sprovues, e cila realizon Mbikëqyrjen Elektronike për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave që vijnë nga</p>	<p>1. The term used in this law shall have the follow meanings:</p> <p>1.1. electronic supervision - means mechanism which guarantees effective implementation of the decisions of the court and those of the Conditional Release Panel, by determining in real-time the location of a person through the utilization of electronic devices placed on his body;</p> <p>1.2. device is the electronic equipment placed on the body of the subject and which enables to determine his location in real-time;</p> <p>1.3. close person is the person who has close family relation with the subject straightaway without limits and in line indirectly until the third degree and/or living in the same house with him;</p> <p>1.4. operation rom- is the office established within Probation Service, carrying out the Electronic supervision for the collection, processing and reporting of the data</p>	<p>1. U ovom zakonu, sledeći termini imaju oho značenje:</p> <p>1.1. elektronski nadzor- je mehanizam koji osigurava efikasno sprovođenje odluka sudova ili odluka veća za uslovni otpust, utvrđujući u realnom vremenu lokaciju jednog lica, korišćenjem elektronskog uređaja koji se nalazi na njegovom telu;</p> <p>1.2. oprema- je elektronski uređaj smešten na telu lica i omogućava utvrđivanje njegove lokacije u realnom vremenu;</p> <p>1.3. bliska- osoba" je osoba koja sa licem ima bliske porodične veze u pravom liniju bez limita i indirektno do trećeg reda i/ili koja sa njim živi u istoj kuci;</p> <p>1.4. operativna sala" je sala uspostavljena od Probacione službe za prikupljanje, obradu i prijavljivanje podataka koja dolaze iz uređaja, i omogućava kontrolu efikasnog</p>

<p>pajisja dhe që mundëson kontrollin e zbatimit efektiv të vendimit gjyqësor dhe të Panelit për Lirim me Kusht;</p> <p>1.5. person nënkupton personin e vendosur nën Mbikëqyrje Elektronike sipas përcaktimeve të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Parimet e Mbikëqyrjes Elektronike</p> <p>1. Veprimtaria e organit të Mbikëqyrjes Elektronike bazohet në parimet:</p> <p>1.1. ligjshmërisë;</p> <p>1.2. mbrojtjes së rendit dhe sigurisë publike;</p> <p>1.3. garantimit të lirisë personale të të dëmtuarit nga vepra penale apo të viktimës;</p> <p>1.4. respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;</p> <p>1.5. mosdiskriminimit;</p> <p>1.6. proporcionalitetit të Mbikëqyrjes Elektronike me rrethanat e rastit dhe personalitetin e personit;</p>	<p>received from the device and which enables effective implementation of the court respectively Conditional Release Panel decision;</p> <p>1.5. person- is the person placed under Electronic supervision, as determined by this law.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Electronic supervision Principles</p> <p>1. The activity of Electronic supervision bodies is grounded on the principle of:</p> <p>1.1. lawfulness;</p> <p>1.2. protection of public order and security;</p> <p>1.3. guaranteeing the personal liberty of the injured by the criminal act or of the victim;</p> <p>1.4. respecting the fundamental human rights and freedoms;</p> <p>1.5. non-discrimination;</p> <p>1.6. electronic supervision proportionality with the case circumstances and the personality of</p>	<p>sprovođenja sudskih odluka i vece za uslovni otpust;</p> <p>1.5. lica- je lice koje je stavljeno pod Elektronskom nadzoru u skladu sa odredbama ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Načela Elektronskog nadzora</p> <p>1. Aktivnosti organa za Elektronskom nadzoru se zasnivaju na načelu:</p> <p>1.1 zakonitosti;</p> <p>1.2. cuvanja javnog reda i bezbednosti;</p> <p>1.3. garantovanja lične slobode oštećenog od krivičnih dela ili žrtava;</p> <p>1.4. poštovanja ljudskih prava i osnovnih sloboda;</p> <p>1.5. nediskriminacije;</p> <p>1.6. proporcionalnosti Elektronski nadzor sa okolnostima slučaja i ličnosti lica;</p>
---	---	---

<p>1.7. objektivitetit dhe efektivitetit.</p> <p style="text-align: center;">KAPITULLI II PËRDORIMI I MBIKËQYRJES ELEKTRONIKE</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Nisma për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike</p> <p>Gjykata, përkatësisht Paneli për Lirim me Kusht vendos për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike me kërkesën e prokurorit, personit, mbrojtësit të tij, të dëmtuarit nga vepra penale, viktimës apo prindërve ose kujdestarit të personit të mitur.</p> <p style="text-align: center;">Neni 6 Pëlqimi i personit</p> <p>1. Gjykata, përpara shpalljes së vendimit përfundimtar, apo të ndonjë vendimi për masat e sigurimit të pranisë së të pandehurit, pyet personin nëse jep pëlqimin për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike dhe i shpjegon atij të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga përdorimi i saj te përcaktuara me këtë ligj.</p> <p>2. Paneli për Lirim me Kusht përpara marrjes së vendimit për lirim me kusht, mundet ta kushtëzoj lirimin me kusht me</p>	<p>the person; 1.7. objectivity and effectiveness.</p> <p style="text-align: center;">CHAPTER II UTILIZATION OF ELECTRONIC SUPERVISION</p> <p style="text-align: center;">Article 5 Initiative for the utilization of Electronic supervision</p> <p>The court respectively Conditional Release Panel decides on the utilization of Electronic supervision upon the request of the prosecutor, of the person, of his defense counsel, of the injured or parents or the juvenile's custodian.</p> <p style="text-align: center;">Article 6 Consent of the person</p> <p>1. Prior to issuing the final decision of the court, or of a decision for the measures to ensure the presence of the defendant, the court asks the person whether he gives the consent for the utilization of Electronic supervision and explains him the rights and obligations stemming from its utilization, foreseen with this law.</p> <p>2. The Conditional Release Panel, prior to issuing the decision of conditional release, may condition the conditional release upon</p>	<p>1.7. objektivnosti i efikasnosti.</p> <p style="text-align: center;">POGLAVLJE II RUKOVANJE ELEKTRONSKI NADZOR</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Inicijativa za korišćenje Elektronski nadzor</p> <p>Sud ili Vece za uslovni otpust određuje korišćenje Elektronski nadzor na zahtev tužioca, subjekata, njegovog branioca, oštećenog krivičnim delom, žrtava ili roditelja ili staratelja maloletnika.</p> <p style="text-align: center;">Član 6 Saglasnost lica</p> <p>1. Sud, pre objavljivanja pravosnažne odluke suda, odnosno odluke o merama za obezbeđivanju prisutnosti okrivljenog, pita lice da li daje pristanak za korišćenje Elektronski nadzor i objašnjava prava i obaveze koje proističu iz njegove upotrebe, kao je predviđeno prema ovom zakonu.</p> <p>2. Veće za Uslovni Otpust, pre donošenja odluke o uslovnom otpustu, može da uvede uslove licu koje se uslovno oslobađa,</p>
--	--	--

<p>pëlqimin e personit për mbikëqyrje elektronike.</p> <p>3. Përdorimi i Mbikëqyrjes Elektronike vendoset vetëm me pëlqimin e personit dhe pasi gjykata ose Paneli për Lirim me Kusht sigurohet se ai i kupton të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga përdorimi i Mbikëqyrjes Elektronike.</p> <p>4. Pëlqimi i personit për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike jepet me shkrim ose nëpërmjet deklarimit në seancë gjyqësore. Në rastin kur personit është i mitur, pëlqimi duhet të jepet në të njëjtën formë edhe nga prindërit ose kujdestari i tij ligjor.</p> <p>5. Nëse personi nuk jep pëlqimin, sipas paragrafit 3 të këtij neni, gjykata apo Paneli për Lirim me Kusht nuk mund të vendosë përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike.</p> <p>6. Mosdhënja e pëlqimit për vendosjen e Mbikëqyrjes Elektronike mund të përdoret si rrethanë në përcaktimin e dënimit, përkatësisht lirimit me kusht.</p> <p>7. Përyjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, gjykata mund të vendosë përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike, edhe pa pëlqimin e personit, në rastin e parashikuar në nenin 2 paragrafin 1, nënparagrafin 1.3 të këtij</p>	<p>the consent of the person for electronic supervision.</p> <p>3. Utilization of Electronic supervision determined only upon the consent of the person and after the court or the Conditional Release Panel is assured that he understands rights and obligations stemming from the utilization of the Electronic supervision.</p> <p>4. The consent of the person for the utilization of Electronic supervision is issued in writing or through the statement at the court session. In the case when the person is a juvenile, the consent should be provided in the same form also by his parents or legal custodian.</p> <p>5. If the person does not give his consent, according to item 3 of this article, the court or the Conditional Release Panel cannot decide to utilize Electronic supervision.</p> <p>6. The fact that the person does not give his consent is kept in consideration in determining the punishment, respectively the conditional release.</p> <p>7. Exceptionally from paragraph 3 of this article, the court may decide to utilize Electronic supervision even without the consent of the person in the case foreseen by article 2, paragraph 1, item 1.3 of this</p>	<p>pristanakom za elektronski nadzor.</p> <p>3. Korišćenje Elektronski nadzor izriče samo uz pristanak lica i nakon što sud ili Veće za Uslovni Otpust osigura da on razume prava i obaveze za korišćenje Elektronski nadzor.</p> <p>4. Pristanak lica za korišćenje Elektronski Nadzor daje se u pisanoj formi ili izjavom na sudskoj sednici. U slučaju da je lice maloletno, pristanak, u istoj formi treba da daju njegovu zakonski roditelji ili staratelji.</p> <p>5. Ukoliko lice ne da pristanak, u skladu sa tačkom 3 ovog člana, sud ili veće ne mogu da nametnu korišćenje Elektronskom nadzoru.</p> <p>6. Kada lice ne da pristanak, ova činjenica, uzina u obzir u određivanju kazne, odnosno uslovnog otpusta.</p> <p>7. U izuzetnim slučajevima od stava 3 ovog člana, sud može da odluči o korišćenju Elektronskom nadzoru bez pristanka lica u slučaju predviđenom u članu 2 stav 1 tačka 1.3 ovog zakona, ako smatra da je</p>
---	--	--

<p>ligji, nëse vlerëson se është e domosdoshme për të garantuar të drejtat kushtetuese të të tretëve dhe ekziston dyshimi i arsyeshëm, se personi paraqet rrezikshmëri për cenimin e këtyre të drejtave.</p> <p>8. Kundër vendimit nga paragrafi 7 i këtij neni mund të paraqitet ankesë me paraqitjen e ankesës kundër vendimit gjyqësor për lëshimin e urdhrit mbrojtës ose urdhrin e mbrojtjes emergjente, të përcaktuara në Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Caktimi i personit të afërt</p> <p>Kur është e mundur, personi cakton një person të afërt, i cili ndihmon në zbatimin e vendimit për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike. Nëse jep pëlqimin të caktohet si i tillë, personi i afërt ka detyrimin të vendosë në dispozicion të gjykatës, Panelit për Lirim me Kusht dhe organit që realizon Mbikëqyrje Elektronike, adresën e tij të saktë dhe numrin e telefonit për kontakt, që duhet të jenë të dispozicion në çdo kohë.</p>	<p>law, if it deems as mandatory in guaranteeing constitutional rights of third parties and when there is reasonable suspicion, that the subject poses danger to the impingement of these rights.</p> <p>8. An appeal may be filed against the decision from paragraph 7 of this article only through appealing the court decision authorizing the issuance of protection order or the emergency protection order, foreseen on the Law for Protection from Domestic Violence.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 Assigning the Close Person</p> <p>When possible, the person assigns another close person of his who shall assist in implementing the decision for the utilization of Electronic supervision . If the consent for such an assignment is provided, the close person is required to make his exact address and telephone numbers available for the court, Conditional Release Panel and the body carrying out the Electronic supervision and these should be available at all times.</p>	<p>neophodno garantovati ustavna prava trećih lica i ako postoji osnovana sumnja, da postoji opasnost da lice prekrši ta prava.</p> <p>8. Protiv odluke iz stava 7 ovog clana se može izjaviti žalba, samo žalbom na sudsku odluku da se naloži zaštita ili hitna zaštita, predviđeno Zakona br. 03/L-182 o zaštiti od nasilja u porodici.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Imenovanje bliske osobe</p> <p>Kada je to moguće, lice određuje osobu koja mu je bliska, koja pomaže u sprovođenju odluke o korišćenju Elektronski nadzor. Ukoliko da pristanak da bude određeno za takvu osobu, bliska osoba ima obavezu da na raspolaganje sudu, Veće za Uslovni Otpust i organu koji realizuje Elektronski nadzor stavi svoju adresu i brojeve telefona za kontakt, koji trebaju da budu dostupni u svakom trenutku.</p>
--	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 8 Vendimi për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike</p> <p>1. Përdorimi i Mbikëqyrjes Elektronike urdhërohet nga gjykata në vendimin gjyqësor të dhënë ndaj personit në rastet e përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji.</p> <p>2. Gjkata, gjatë gjykimit para marrjes së vendimit, në rastet e përcaktuara në paragrafin 1, nënparagrafin 1.2 të nenit 2 të këtij ligji, i kërkon Shërbimit Sprovues një raport parandëshkues për të pandehurin dhe nevojën e përdorimit të Mbikëqyrjes Elektronike.</p> <p>3. Afati i kohëzgjatjes së Mbikëqyrjes Elektronike përcaktohet me vendim të gjykatës, përkatësisht të Panelit me Lirim me Kusht Afati i kohëzgjatjes së mbikëqyrjes elektronike nuk mund të jetë më i gjatë se një (1) vit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 The decision for the utilization of Electronic supervision</p> <p>1. Utilization of Electronic supervision is ordered by the court through a court decision issued to person in cases foreseen in Article 2 of this law.</p> <p>2. During the judgment prior to issuing the decision, in cases foreseen by paragraph 1, item 1.2 of article 2 of this law, the court shall require the Probation Service a pre-punitive report for the defendant and the need to use Electronic supervision .</p> <p>3. The deadline of the timeframe of the Electronic supervision is determined by a court decision, respectively by a Conditional Release Panel. The deadline of the electronic supervision timeframe shall not be longer than 1 year.</p>	<p style="text-align: center;">Član 8 Odluka o korišćenju Elektronski nadzor</p> <p>1. Korišćenje Elektronski nadzor nalaže se sudskom odlukom donetom protiv lica u slučajevima predviđenim u članu 2 ovog zakona.</p> <p>2. Sud, tokom suđenja pre donošenja odluke, u slučajevima predviđenim u stavu 1, tačka 1.2 člana 2 ovog zakona, zahteva od probacione službe preventivni izveštaj za okrivljenog i potrebu za korišćenje Elektronski nadzor.</p> <p>3. Vreme trajanja Elektronski nadzor određuje se odlukom suda, odnosno odlukom Veće za Uslovni Otpust. Rok trajanja elektronskog nadzora ne može biti duži od 1 godine.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Përmbajtja e vendimit</p> <p>1. Vendimi gjyqësor që urdhëron përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike përveç si përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale, përkatësisht vendimi i panelit për lirim me kusht për përdorim të Mbikëqyrjes Elektronike përmban edhe:</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Content of the Decision</p> <p>1. The court decision authorizing the use of Electronic supervision, apart from what is foreseen by the Criminal Procedure Code, respectively the decision of the conditional release panel for the use of Electronic should also contain:</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Sadržaj odluke</p> <p>1. Sudska odluka koja nalaže korišćenje Elektronski nadzor, osim onoga što je propisano u Zakonu o krivičnom postupku, odnosno odluka veća za uslovni otpust za korišćenje Elektronski nadzor, obuhvata, i:</p>

<p>1.1. pëlqimin nga personi si përcaktohet me këtë ligj, apo pëlqimin nga prindi apo kujdestari i personit të mitur, për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike;</p> <p>1.2. zonat e lejuara dhe zonat e ndaluara të lëvizjes së personit;</p> <p>1.3. detyrimin e personit për të qëndruar brenda zonës së lejuar ose për të mos hyrë në zonën të ndaluara;</p> <p>1.4. kohëzgjatjen e përdorimit të Mbikëqyrjes Elektronike, nëse gjykata, përkatësisht Paneli për Lirim me Kusht urdhëron përdorimin e saj, sipas një afati të caktuar.</p>	<p>1.1. the subject's consent, when required by law, and/or from parents or the custodians of the juvenile for the utilization of the Electronic supervision;</p> <p>1.2. person's permissible and prohibited movement zones;</p> <p>1.3. the requirement of the person to remain within the permissible zone or to not enter prohibited zones;</p> <p>1.4. the time of Electronic supervision utilization, if the court, respectively the Conditional Release Panel orders its utilization, according to a specified timeframe.</p>	<p>1.1. pristanak subjekta, kada se to zahteva zakonom, i/ili od roditelja ili staratelja maloletnika, za korišćenje Elektronski nadzor;</p> <p>1.2. dozvoljene zone i zabranjene zone kretanja lica;</p> <p>1.3. obavezu lica da boravi u odobrenoj zoni ili o neulasku u zabranjenu zonu;</p> <p>1.4. vreme korišćenja Elektronski nadzor, ukoliko sud, odnosno Veće za Uslovni Otpust naloži njegovo korišćenje, u skladu sa određenim rokom.</p>
<p style="text-align: center;">KAPITULLI III REALIZIMI I MBIKËQYRJES ELEKTRONIKE</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Organi që realizon Mbikëqyrjen Elektronike</p>	<p style="text-align: center;">CHAPTER III EM IMPLEMENTATION</p> <p style="text-align: center;">Article 10 The Electronic supervision implementing body</p>	<p style="text-align: center;">POGLAVLJE III REALIZACIJA ELEKTRONSKI NADZOR</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Organ koji realizuje Elektronski nadzor</p>
<p>1. Shërbimi Sprovues realizon Mbikëqyrjen Elektronike dhe është përgjegjës për vendosjen, heqjen dhe funksionimin e rregullt të pajisjes.</p> <p>2. Vendi, koha dhe rregullat për vendosjen</p>	<p>1. Probation Service implement the Electronic supervision and is responsible for the placement, removal and proper functioning of the device.</p> <p>2. The location, time and rules for the</p>	<p>1. Organ koji realizuje Elektronski nadzor je probacione službe Kosova i odgovoran za postavljanje, uklanjanje i pravilno funkcionisanje opreme.</p> <p>2. Mesto, vreme i propise za postavljanje i</p>

<p>dhe heqjen e pajisjes përcaktohen në urdhrin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, ose të vendimit të panelit për lirim me kusht, të cilët e njoftojnë menjëherë personit dhe organin që realizon Mbikëqyrjen Elektronike.</p> <p>3. Organi që realizon Mbikëqyrjen Elektronike, nëpërmjet sallës operative mbledh, përpunon dhe raporton të dhënat që vijnë nga pajisja.</p> <p>4. Kriteret që duhet të plotësojë organi që realizon Mbikëqyrjen Elektronike, të drejtat dhe detyrimet e tij caktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë.</p>	<p>placement and removal of the device are determined in the order for the execution of the court decision, or of the conditional release panel decision who immediately notify the person and the body implementing the Electronic supervision.</p> <p>3. The Electronic supervision implementing body, through the operation room, shall collect, process and report the data transmitted by the device.</p> <p>4. The criteria which the Electronic supervision implementing body should meet, its rights and obligation are determined by sublegal act issued from the Minister of Justice.</p>	<p>uklanjanje opreme navedeni su u nalogu za izvršenje sudske odluke, ili odluke veća za uslovni otpust, o kojima se odmah obaveštavaju lice i organ koji realizuje Elektronski nadzor.</p> <p>3. Organ koji realizuje Elektronski nadzor, preko operative sale, prikuplja, obrađuje i prijavljuje podatke koji dolaze sa uređaja.</p> <p>4. Kriterijumi koje mora da ispuni organ koji realizuje Elektronski nadzor, i njegova prava i obaveze utvrđuju se podzakonskom aktom od Ministara Pravde.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Shërbimi Sprovues</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Probation Service</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Probaciona služba</p>
<p>1. Shërbimi Sprovues, është organ përgjegjës për të kontrolluar mënyrën e realizimit të Mbikëqyrjes Elektronike.</p> <p>2. Udhëheqësi i Shërbimit Sprovues, informon Ministrin e Drejtësisë për zbatimin e realizimit të Mbikëqyrjes Elektronike.</p> <p>3. Shërbimi Sprovues, i ofron gjykatës dhe Panelit për Lirim me Kusht, të dhëna të përditësuara për pajisje në dispozicion për</p>	<p>1. The Probation Service is the body responsible to control the Electronic supervision implementing manner.</p> <p>2. The head of Probation Service shall periodically inform the Minister of Justice on the Electronic supervision implementation.</p> <p>3. Every week, the Probation Service shall make available before the court or the Conditional Release Panel updated data</p>	<p>1. Probaciona služba za uslovni otpust je organ odgovoran za kontrolu načina realizacije Elektronski nadzor.</p> <p>2. Direktor Probaciona služba, periodično informiše Ministar pravde o sprovođenju Elektronskom nadzoru.</p> <p>3. Probaciona služba, svake nedelje stavlja na raspolganje sudu ili veću, podatke o broju uređaja na raspolaganju za korišćenje i</p>

